

Ac.nr.1352/14

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, ne kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Qerim Ademaj, kryetar i kolegjit, Fejzullah Rexhepi dhe Zenel Leku , anëtar te kolegjit , në çështjen juridike kontestimore të paditësve [redacted] nga Istogu dhe [redacted], nga fshati [redacted], Komuna e Istogut, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Bajram Mujaj, avokat në Pejë, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Venhar Hana, jurist i të paditurës, për kompensim dëmi nga baza e autopërgjegjësisë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, C.nr.212/11 i datës 01.04.2014, si dhe ankesës së të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog C.nr.212/11, i datës 30.01.2014, në seancën jo publike të mbajtur me date 14.01.2019, mori këtë:

### AKTGJYKIM

I. Me aprovimin si të bazuar të ankesës së të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, ANULOHET aktvendimi Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, C.nr.212/11 i datës 01.04.2014, dhe ankesa e të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog C.nr.212/11, i datës 30.01.2014, trajtohet si e afatshme.

II. REFUZOHET pjesërisht si e pabazuar ankesa e të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, dhe VËRTETOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog C.nr.212/11, i datës 30.01.2014, në pikën I (një) të dispozitivit, në pjesën e kërkesëpadisë së paditësit [redacted] nga Istogu, për kompensimin e dëmit material në emër të shpenzimeve për kujdes dhe ndihmë të huaj.

III. Me aprovimin e pjesshëm si të bazuar të ankesës së të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog C.nr.212/11, i datës 30.01.2014, në pikën I (një) të dispozitivit, në pjesën e kërkesëpadisë së paditësit [redacted] nga Istogu, për kompensimin e dëmit jo material në emër të dhimbjeve fizike trupore, frikës së përjetuar, zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtimit trupor, pjesën e kërkesëpadisë së paditësit [redacted] nga fshati [redacted], Komuna e Istogut, për kompensimin e dëmit jo material në emër të dhimbjeve fizike trupore, frikës së përjetuar, zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtimit trupor si dhe kompensimin e dëmit material në emër të shpenzimeve për kujdes dhe ndihmë të huaj, si dhe në pikën III (tre) të dispozitivit lidhur me kumatën ligjore, ashtu që në këtë pjesë gjykohet si në vijim:

DETYROHET e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, që paditësit [redacted] nga Istogu në emër të zhdëmtimit të dëmit jo material, nga baza e autopërgjegjësisë për aksidentin e ndodhur me datë 05.08.2011, t'ia paguajë shumat si në vijim:

-në emër të dhimbjeve fizike trupore, shumën prej 7.500,00 Euro,

- në emër të frikës së përjetuar, shumën prej 4.500,00 Euro,
- për zvogëlim të aktivitetet të përgjithshëm jetësor, shumën prej 13.500,00 Euro,
- për shëmtim trupor, shumën prej 2.500,00 Euro.

Gjithsejtë, shumën prej 28.000,00 (njëzet e tetë mijë ) euro.

Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit [REDAKTUAR] nga Istogu, për kompensim të dëmit jo material në emër të dhimbjeve fizike trupore, frikës së përjetuar, zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtimit trupor, mbi shumat e gjykuara REFUZOHET SI E PABAZUAR.

DETYROHET e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, që paditësit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR], Komuna e Istogut, në emër të zhdëmtimit të dëmit jo material dhe material, nga baza e autopërgjegjësive për aksidentin e ndodhur me datë 05.08.2011, t'ia paguajë shumat si në vijim:

- në emër të dhimbjeve fizike trupore, shumën prej 7.000,00 Euro,
- në emër të frikës së përjetuar, shumën prej 4.500,00 Euro,
- për zvogëlim të aktivitetet të përgjithshëm jetësor, shumën prej 13.000,00 Euro,
- për shëmtim trupor, shumën prej 2.500,00 Euro.
- për ndihmë dhe kujdes të huaj, shumën prej 300.00 Euro.

Gjithsejtë shumën prej 27.300,00 (njëzet e shtatë mijë e treqind ) euro.

Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit [REDAKTUAR] nga fshati Orobërd, Komuna e Istogut, për kompensim të dëmit jo material në emër të dhimbjeve fizike trupore, frikës së përjetuar, zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtimit trupor, si dhe kompensimin e dëmit material në emër të shpenzimeve për kujdes dhe ndihmë të hua, mbi shumat e gjykuara REFUZOHET SI E PABAZUAR.

DETYROHET e paditura, që paditësve shumat e gjykuara në emër të dëmit material dhe jo material, t'ua paguajë me kamatë vjetore si për mjetet e deponuara të qytetarëve mbi një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, datë 30.01.2014, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.

IV. Me aprovimin e pjesshëm si të bazuar të ankesës së të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, PRISHET aktgjykimi Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog C.nr.212/11, i datës 30.01.2014, në pikën I (një) të dispozitivit, në pjesën e kërkesëpadisë së paditësit [REDAKTUAR] nga Istogu, për kompensimin e dëmit material në emër të shpenzimeve të mjekimit dhe zvogëlimit të aftësisë punuese (fitimit të humbur), si dhe në pjesën e kërkesëpadisë së paditësit [REDAKTUAR] nga fshati Orobërd, Komuna e Istogut, për kompensimin e dëmit material në emër të shpenzimeve të mjekimit dhe zvogëlimit të aftësisë punuese (fitimit të humbur), si dhe pika IV (katër) e dispozitivit të te njëjtit aktgjykim, në pjesën e kërkesëpadisë së paditësve për kompensimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore.

V. Aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog C.nr.212/11, i datës 30.01.2014, në pikën II (dy) të dispozitivit mbetet i pashqyrtuar.

## Arsyetim

Gjykata e shkallë së parë me aktgjykimin .nr.212/11, i datës 30.01.2014, ka vendosur:

PJESËRISHT APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësve [REDACTED], nga Istogu, dhe [REDACTED], nga fshati [REDACTED] Komuna e Istogut.

I. DETYROHET e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, që paditësve [REDACTED], nga Istogu, dhe [REDACTED], nga fshati [REDACTED] Komuna e Istogut, në emër të zhdëmtimit-kompensimit të dëmit nga autopërgjegjësia për aksidentin e ndodhur me datë 05.08.2011, t'ua paguajë shumat e specifikuara si më poshtë:

Paditësit [REDACTED],

Dëmi jo material:

Zhdëmtim në emër të dhimbjeve fizike trupore për të gjitha llojet, shumën prej 10.000,00 Euro.

Zhdëmtim në emër të frikës së përjetuar për të gjitha llojet, shumën prej 8.000,00 Euro,

Zhdëmtim për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumën prej 32.000,00 Euro.

Zhdëmtim trupor për dhimbje shpirtërore për shëmtim, shumën prej 4.500,00 Euro.

Dëmi material:

Shpenzimet e mjekimit, shumën prej 6.248,00 Euro.

Shpenzimet për kujdes dhe ndihmë të huaj, shumën prej 600.00 Euro.

Në emër të zvogëlimit të aftësisë punuese-fitimit të humbur, t'ia paguajë shumën prej 77.241,67 Euro, për periudhën duke filluar nga data 05.08.2011, e deri me datë 31.10.2013, si dhe për çdo muaj shumën prej 2.874,54 Euro, duke filluar nga data 31.10.2013, e në të ardhmen, gjersa të ekzistojnë kushtet ligjore për pagimin e saj, dhe atë shumat e arritura në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit, ndërsa shumat e tjera që arrijnë më vonë të paguhet më së largu deri me datë 05 të muajit vijues për muajt e kaluar.

Paditësit [REDACTED],

Dëmi jo material

Zhdëmtim në emër të dhimbjeve fizike trupore për të gjitha llojet, shumën prej 9.000,00 Euro.

Zhdëmtim në emër të frikës së përjetuar për të gjitha llojet, shumën prej 8.000,00 Euro,

Zhdëmtim për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumën prej 31.000,00 Euro.

Zhdëmtim trupor për dhimbje shpirtërore për shëmtim, shumën prej 4.500,00 Euro.

Dëmi material:

Shpenzimet e mjekimit, shumën prej 261.00 Euro.

Shpenzimet për kujdes dhe ndihmë të huaj, shumën prej 600.00 Euro.

Në emër të zvogëlimit të aftësisë punuese-fitimit të humbur, t'ia paguajë shumën prej 4.024,00 Euro, për periudhën duke filluar nga data 05.08.2011, e deri me datë 31.10.2013, si dhe për çdo muaj shumën prej 149.60 Euro, duke filluar nga data 31.10.2013, e në të ardhmen, gjersa të ekzistojnë kushtet ligjore për pagimin e saj, dhe atë shumat e arritura në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit, ndërsa shumat e tjera që arrijnë më vonë të paguhen më së largu deri me datë 05 të muajit vijues për muajt e kaluar.

II. REFUZHET pjesërisht si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve [REDACTED] nga Istogu, dhe N [REDACTED], nga [REDACTED], Komuna e Istogut, përtej shumës së gjykuar, si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, e për shumat e specifikuar si më poshtë:

Paditësi [REDACTED],

Dëmi jo material

Zhdëmtim në emër të dhimbjeve fizike trupore për të gjitha llojet, shumën prej 1.000,00 Euro.

Zhdëmtim në emër të frikës së përjetuar për të gjitha llojet, shumën prej 1.000,00 Euro,

Zhdëmtim për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumën prej 3.000,00 Euro.

Zhdëmtim trupor për dhimbje shpirtërore për shëmtim, shumën prej 500,00 Euro.

Dëmi material:

Shpenzimet për ushqim të përforcuar, shumën 1.500,00 Euro.

Shpenzimet për kujdes dhe ndihmë të huaj, shumën prej 300.00 Euro.

Paditësit N [REDACTED]

Dëmi jo material,

Zhdëmtim në emër të dhimbjeve fizike trupore për të gjitha llojet, shumën prej 2.000,00 Euro.

Zhdëmtim në emër të frikës së përjetuar për të gjitha llojet, shumën prej 1.000,00 Euro,

Zhdëmtim për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumën prej 2.000,00 Euro.

Zhdëmtim trupor për dhimbje shpirtërore për shëmtim, shumën prej 500,00 Euro.

Dëmi material:

Shpenzimet për ushqim të përforcuar, shumën prej 500.00 Euro.

III. DETYROHET e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve në Prishtinë, që shumat e gjykuara si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi t'i paguajë me kamatën sipas normës prej 8% në vit, duke filluar nga data 30.01.2013, e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

IV. DETYROHET e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve në Prishtinë, që paditësve t'iu paguajë edhe shpenzimet kontestimore, në lartësi prej 4.663,00 Euro, të gjitha këto t'i përmbush në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim te gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës t'a aprovojë ankesën e ushtruar duke e ndryshuar aktgjykimin e goditur, ose të njëjtin t'a prishë dhe lëndën t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

I autorizuari i paditësve nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të ankesës së parashtruar nga e paditura të cilën e kishte paraqitur kundër aktgjykimin të ankimuar C.nr.212/11, i datës 30.01.2014, me aktvendimin e ankimuar C.nr.212/11, i datës 01.04.2014, ankesën e të paditurës e hedhë poshtë si të paafatshme.

Kundër këtij aktvendimi e paditura në afatin ligjor paraqet ankesë duke e goditur për shkak të shkeljeve thelbësorë të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me propozim bërë Gjykatës së Apelit, që aktvendimi i ankimuar për hedhjen poshtë të ankesës si të paafatshme, të datës 01.04.2014, të anulohet, ndërsa aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë C.nr.212/11, i datës 30.01.2014, të priset dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje te gjykata e shkallës së parë.

I autorizuari i paditësve nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës pas ekzaminimit dhe vlerësimit të aktgjykimin dhe aktvendimit të ankimuar të nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë, pretendimeve ankimore, si dhe analizimit dhe vlerësimit të komplet shkresave lëndore, konform dispozitave ligjore të nenit 194 të LPK-së, gjeti:

-Ankesa e të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimin të ankimuar C.nr.212/11, i datës 30.01.2014, është pjesërisht e bazuar, ndërsa ankesa e të paditurës e paraqitur kundër aktvendimit të ankimuar C.nr.212/11, i datës 01.04.2014, është në tërësi e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit përmes të autorizuarit të tyre në gjykatën e shkallës së parë kanë paraqitur padi, kundër të paditurës, për kompensim të dëmit material dhe jo material, nga baza e autopërgjegjesisë, të cilën së fundi herë e kanë rregulluar dhe precizuar me parashtrësën e datës 05.12.2013, me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësve në emër të dëmit jo material dhe material i cili u është shkaktuar në aksidentin e datës të ndodhur me datë 05.08.2011, t'ua paguajë shumën e përgjithshme prej 638.887,66 Euro, me kamatë ligjore në shkallës prej 8%, të llogaritura nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare, duke përfshirë edhe pagesën e shpenzimeve procedurale sipas listës së shpenzimeve të prezantuara gjykatës, të gjitha këto e paditura t'i përmbush në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimin në dorëzim, nën kërcënim të përmbarimit.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë dhe kërkesës së saj, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor në të cilën sipas propozimit të palëve ka nxjerrë dhe administruar provat nga shkresat e lëndës, me vlerësimin e të cilave pas përfundimit të shqyrtimit kryesor ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar, ku edhe ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.212/11, i datës 30.01.2014, duke vendosur më decidivishtë si në dispozitivin e të njëjtit.

Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se me provat e nxjerra dhe të administruara gjatë shqyrtimit kryesor është vërtetuar se me datë 05.08.2011, rreth orës 2:30, kishte ndodhur aksidenti i trafikut në fshatin Dollc, Komuna e Klinës, ku gjerë tek ky aksident kishte ardhur për derisa drejtuesi i automjetit VË me targa të regjistrimit GFN-231 të cilin në momentin e aksidentit ishte duke drejtuar ~~.....~~, nga fshati ~~.....~~, Komuna e Istogut, ashtu që gjatë qarkullimit në rrugën Gjakovë-Klinë, duke mos e përshtatur shpejtësinë, kushteve të rrugës, kur arrin në udhëkryqin e rrugës kryesore Pejë-Prishtinë, duke mos mundur të marrë veprimin e kthimit në të majtë në drejtim të Pejës, del jashtë rrugës duke fluturuar në ajër në distancë prej 45.90 metra, duke përfunduar në një livadh, e ku si pasojë e kësaj lëndime të rënda trupore marrin këtu paditësit të cilët ishin bashkudhëtar në të njëjtën veturë.

Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se e njëjta gjatë shqyrtimit kryesor nuk ishte kontestuese në mes ndërgjyqësve, për faktin se e paditura edhe në përgjigje në padi, por edhe gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, përmes të autorizuarit të saj, shprehimisht është deklaruar se për të paditurën nuk është kontestuese baza e kërkesëpadisë, kontestuese është vetëm lartësia e kërkesëpadisë.

Lidhur me vërtetimin e lartësisë së kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë në arsyetim ka theksuar se për këtë si provë ka nxjerrë ekspertizën mjekësore, përkatësisht mendimin profesional të dhënë nga ekspertët Dr. Isa Kaliqanaj, Ortoped-Traumatolog, Dr. Muhamet Halitaj, Psikiatër, Dr. Kujtim Zajmi, ekspert nga lëmia e punës, Dr. Edmond Shabi, Kirurg maksofacial, Dr. Armend Kreveshi, Neurokirurg, dhe super ekspertizën nga lëmia financiare-aktuaristikës e punuar më datë 31.10.2013 nga grupi i ekspertëve gjyqësor, Riza Blakaj, auditor, Bashkim Uka, auditor dhe Bashkim Krasniqi, ekonomist i diplomuar, në bazë të së cilave është konstatuar:

Paditësi ~~.....~~, pas ekzaminimit klinik-fizik, dhe vlerësimit të dokumentacionit mjekësor nga shkresat e lëndës, si pasojë e aksidentit të shkaktuar është diagnostikuar me diagnozën politrauma, thyerja e procesit avolar të masillës, thyerje e diattines së radiusit të djathtë, thyerje në regjionin në nyje tarorurale të majtë, thyerje në regjionin e kërcirit të djathtë, thyerje e trupit të unazës L3, L4 të mesit, gërvishje në regjionin e kokës dhe të mjekrës, thyerje e eshtrave të hundës, stabilizim i pasëm i intervenimit kirurgjikal, stabilizimi i pasëm nga unaza L2, L5, ose sintezë e radiusit të djathtë e kërcerit të djathtë, dhe kërcerit të këmbës së majtë, të cilat karakterizohen si lëndime të natyrës së rëndë. Ka pësuar dhimbje fizike të intensitetit jashtëzakonisht të lartë në kohëzgjatje prej 3 orësh, të intensitetit të lartë 35 ditë, të intensitetit të mesëm 3 muaj, ndërsa dhimbje të intensitetit të ulët ka edhe tani, janë kronike gjatë uljes, ecjes etj. Ka përjetuar frikë primare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 2 minutave, frikë sekondare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 4 orësh, frikë sekondare të intensitetit të mesëm në periudhën kohore prej 8 muaj, dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët në periudhën kohore prej 1 viti. Gjatë kësaj periudhe i njëjti ka përjetuar edhe dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë për shkak të natyrës së lëndimit dhe kufizimit të aktivitetit të përditshëm jetësor. Ka pësuar shëmtim në shkallë

të mesme, zvogëlimi i përgjithshëm dhe i përhershëm i aktivitetit jetësor është në masë prej 45.125%, zvogëlimi i përgjithshëm dhe i përhershëm i aktivitetit punues (profesionit), në shkallë 100%, ka pasur nevojë për kujdes nga personi i tretë në kohëzgjatje prej 3 muaj, ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 6 muaj, dhe rehabilitimi fiziatrik dhe mjekimi ka qenë i nevojshëm 2 herë në vit, nga 2 javë, për 2 vite rresht pa përcjellje të personit të tretë.

Si shkak i zvogëlimit të aktivitetit punues të përhershëm në shkallën 100%, paditësi [redacted], ka pësuar fitim të humbur e cila llogaritur nga data e aksidentit 05.08.2011, e deri me datën e ekspertimit 31.10.2013, së bashku me kamatë përfshinë shumën prej 79.939,62 Euro, ndërsa nga data 01.11.2013, e tutje, derisa të ekzistojnë kushtet ligjore për një gjë të tillë renta mujore është në shumën prej 2.874,54 Euro.

Paditësi [redacted], pas ekzaminimit klinik-fizik, dhe vlerësimit të dokumentacionit mjekësor nga shkresat e lëndës, si pasojë e aksidentit të shkaktuar ka përjetuar thyerje komunitive e qafokut të djathtë, nxjerrje e kërrlokës së majtë, tronditje e trurit, ndrydhje koke dhe trupi, dhe gërvishje të fytyrës të cilat karakterizohen si lëndime të rënda trupore, si shkak i të cilave është bërë repunimi i kërrlokës së majtë, tranzicioni këmbës së djathtë përmes dy operacioneve të një pas njëshme. Ka pësuar dhimbje fizike të intensitetit jashtëzakonisht të lartë në kohëzgjatje prej 3 orësh, të intensitetit të lartë 3 ditë, të intensitetit të mesëm 2 muaj, ndërsa dhimbje të intensitetit të ulët ka edhe tani. Ka përjetuar frikë primare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 3-4 minutave, frikë sekondare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 4 orësh, frikë sekondare të intensitetit të mesëm në periudhën kohore prej 6 muaj, dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët ka edhe tani. Ka pësuar shëmtim në shkallë të mesme, zvogëlimi i përgjithshëm i aktivitetit jetësor është në masë prej 40%, zvogëlimi i përgjithshëm dhe i përhershëm i aktivitetit punues (profesionit), në shkallë 40%, ka pasur nevojë për kujdes nga personi i tretë në kohëzgjatje prej 6 javë, ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 2 muaj, dhe rehabilitimi fiziatrik dhe mjekimi ka qenë e domosdoshme ambulator apo stacionar pas tretmanit të parë dhe të dytë, së paku 2 herë nga 2 javë, ndërsa për shkak të ndryshimeve në kërdhokun e majtë terapia fizikale është e nevojshme edhe më tej së paku 2 herë në vit.

Si shkak i zvogëlimit të aktivitetit punues në shkallën 40%, paditësi [redacted], ka pësuar fitim të humbur e cila llogaritur nga data e aksidentit 05.08.2011, e deri me datën e ekspertimit 31.10.2013, së bashku me kamatë përfshinë shumën prej 4.164,97 Euro, ndërsa nga data 01.11.2013, e tutje, derisa të ekzistojnë kushtet ligjore për një gjë të tillë renta mujore është në shumën prej 149.60 Euro.

Mendimit profesional të dhënë nga ana e ekspertëve mjekësor si dhe super ekspertizës nga lëmia financiare e punuar nga grupi i ekspertëve lidhur me fitimin e humbur i shkaktuar paditësve, gjykata e shkallës së parë del t'iu ketë falur besimin e plotë, duke vlerësuar se të njëjtat janë të plota, të qarta dhe në përputhje të plotë edhe me provat tjera nga shkresat e lëndës.

Duke u nisur kjo gjendje faktike e vërtetuar gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve lidhur me dëmin jo material dhe material të kërkuar është pjesërisht e bazuar, me çka ka vendosur si në pikën I (një) të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, e duke u mbështetur në dispozitat ligjore të nenit 154, 158, 178, 193, 195, dhe 200 të LMD-së. Për kamatën gjykata ka vendosur në mbështetje të dispozitës së nenit 186 dhe 277 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 449 dhe 452 të LPK.

Gjykata e Apelit të Kosovës, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare ne kuptim te nenit 194 të LPK, ka konstatuar se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje nga neni 182.2 pika b), g), j), k) dhe m) të LPK, për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare ne mbeshetje te nenit 194 të LPK.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Gjykata e shkallës së parë duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit [redacted] nga Istogu është e bazuar në pjesën e kërkesëpadiës për kompensimin e dëmit material në emër të shpenzimeve për kujdes dhe ndihmë te huaj. Kjo për faktin se ne bazë te mendimit profesional të dhënë nga ekspertët mjekësor Dr. Isa Kaliqanaj, Ortoped-Traumatolog, Dr. Muhamet Halitaj, Psikiatër, Dr. Kujtim Zajmi, ekspert nga lëmia e punës, Dr. Edmond Shabi, Kirurg maksofacial dhe Dr. Armend Kreveshi, neurokirurg, është konstatuar se ky paditës si shkak i natyrës se lëndimeve te rënda trupore te cilat i kishte pësuar ne aksidentin e ndodhur ka pasur nevojë për kujdes nga personi i tretë në kohëzgjatje prej 3 muaj, gjë e cila sipas Gjykatës se Apelit edhe ka rezultuar me humbje materiale të paditësit, pa marrë parasysh se përkujdesjen ndaj tij ka mundur ta ushtron ndonjë familjar i tij apo edhe person tjetër jashtë familjes se tij, i cili më kompensim është angazhuar qe të përkujdeset për paditësin gjatë kësaj periudhe 3 mujore.

Sa i përket kompensimit të dëmit jo material në emër të dhimbjeve fizike trupore, frikës së përjetuar, zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor si dhe shëmtimit trupor të cilin e kanë pësuar paditësit si shkak i lëndimeve trupore të marra në aksidentin e shkaktuar, Gjykata e Apelit, duke marr për bazë pjesërisht si të bazuar pretendimin ankimor të palës ankuese, aktgjykimin e ankimuar e ka ndryshuar në këtë pjesë duke vendosur më decidivishtë si në pikën III (tre) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për faktin se kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike për këtë pjesë të kërkesëpadiës nga gjykata e shkallës së parë është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, mirëpo e drejta materiale nuk është aplikuar në përputhshmëri me dispozitat ligjore materiale të cilat e përcaktojnë kompensimin për këtë kategori të dëmit jo material.

Është vlerësim i Gjykatës së Apelit se përcaktimi i kompensimit (satisfaksionit) në shumat e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë, paditësve në emër të dëmit jo material sipas aktgjykimit të ankimuar, nuk përkon me rendësin e të mirës së sëmur dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 200 par. 1 e 2 të LMD-së, me çka kjo gjykatë paditësit [redacted], për dëmin jo material të kërkuar ja gjykoj shumë e tërësishme prej 28.000,00 €, (njëzet e tetë mijë euro), ndërsa paditësit [redacted] shumë e tërësishme prej 27.300,00 € (njëzet e shtatë mijë euro), duke vlerësuar se këto shuma të gjykuara paditësve do t'ua mundësojnë që të plotësojnë disa nevoja të përditshme, duke ua bërë deri diku më të lehtë jetën e tyre dhe harruar përjetimin e pakëndshëm të cilin e kanë pësuar si pasojë e aksidentit të ndodhur dhe lëndimeve të marra në këtë aksident.

Lidhur me lartësinë e kompensimit për këtë lloji dëmi jo material të gjykuar paditësve, Gjykata e Apelit mori parasysh posaçërisht natyrën e lëndimeve trupore të pësuar, për secilin paditës veç e veç, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike të tyre, intensitetin, kohëzgjatjen dhe mënyrën e manifestimit të frikës të cilën e kanë pësuar, përqindjen e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shkallën e shëmtimit të cilin e kanë pësuar në aksidentin e ndodhur, e sipas gjetjeve dhe mendimit profesional të dhënë nga ekspertët mjekësor të cilët kanë bërë ekzaminimin klinik fizik të paditësve, e duke marr për bazë edhe moshën relativisht të re të paditësve në kohën e ndodhjes së aksidentit por edhe praktikën e gjer tanishme gjyqësore, duke u siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësit duke shmangur qëllimet tjera



materiale (lukrative), që mund të bije ndesh me qëllimin e satisfaksionit për raste të tilla.

Gjykata e Apelit, me pikën III (tre), të dispozitivit të këtij aktgjykimi, aktgjykimin e ankimuar të nxjerr nga gjykata e shkallës së parë e ka ndryshuar edhe në pjesën e kërkesëpadisë së paditësit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna e Istogut, për kompensimin e dëmit material për ndihmë dhe kujdes të huaj, pasi që kjo gjykatë ka vlerësuar se përkundër faktit se në bazë të mendimit të ekspertëve mjekësor është konstatuar se paditësi [REDACTED], si shkak i lëndimeve trupore të marra në aksidentin e ndodhur ka pas nevojë për ndihmë dhe kujdes të huaj në kohëzgjatje prej 6 jave, shuma e gjykuar nga gjykata e shkallës së parë nuk është në përputhje me praktikën e gjertanishme gjyqësore, me çka Gjykata e Apelit për këtë lloji dëmi paditësit ja gjykoj shumë prej 300 €, duke vlerësuar dhe konsideruar se kjo shumë e gjykuar përkon me dëmin real të cilin paditësi ka mundur ta pëson dhe është në përputhje edhe me praktikën e gjertanishme gjyqësore.

Pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë më shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit është pretendim tërësisht i paqëndrueshëm, për faktin se kjo gjykatë konstaton se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar, lidhur me pjesën e kërkesëpadisë së paditësve në të cilën Gjykata e Apelit me pikën I (një) të dispozitivit të këtij aktgjykimi e ka vërtetuar, ndersa me pikën II (dy) të dispozitivit të këtij aktgjykimi e ndryshuar, është mjaft i qartë e në përputhje të plotë më arsyet e dhëna, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë për këtë pjesë të kërkesëpadisë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë, ku në lidhshmëri me këtë edhe ka arsyetuar qartë mënyrën se si janë vërtetuar faktet dhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, të cilat janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë.

Te pathemelta Gjykata e Apelit i konsideron të gjitha pretendimet ankimore te palës ankuese lidhur me gjendjen faktike te konstatuar, ngase kjo gjykatë konsideron se aktgjykimi i ankimuar në pjesën e kërkesëpadisë së paditësve, e cila është vërtetuar dhe ndryshuar përmes këtij aktgjykimi nga gjykata në shkallës së dytë, përmban arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes kontestuese në fjalë, të cilat janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në procedurën kontestimore të udhëhequr, ku gjykata e shkallës së parë për këtë pjesë të kërkesëpadisë së paditësve del te ketë dhënë arsye bindëse lidhur me faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes, e cila gjendje faktike edhe sipas gjykatës ankimore ka mbështetje në provat nga shkresat e lëndës dhe në ligj.

Gjykata e Apelit duke marr pjesërisht si të bazuar ankesën e palës ankuese, për vërtetim jo të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës material, me pikën IV (katër) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, aktgjykimin e ankimuar e ka prishur në pjesën e kërkesëpadisë së paditësve për kompensimin e dëmit material në emër të zvogëlimit të aftësisë punuese (fitimit të humbur) si dhe kompensimin e shpenzimeve të mjekimit, për faktin se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të ankimuar nuk ka dhënë arsye bindëse dhe të argumentuar mirë, pse ja ka falur besimin super ekspertizës nga lëmia financiare e punuar nga grupi i ekspertëve Riza Blakaj, Bashkim Uka dhe Maliq Krasniqi, ndërsa nuk i ka falur besimin ekspertizave të kësaj lëmie të nxjerra dhe të punuara paraprakisht në mënyrë të pavarur nga ekspertët financiar (aktuar) Ukë Sadiku dhe Aziz Berisha, të cilat gjenden si dëshmi në shkresat e lëndës, dhe se me cilat prova gjykata e ka vërtetuar lartësinë e

kërkespadi së se paditësve, për secilin veç e veç sa i përket shpenzimeve te mjekimit ne shumat të cilat ju ka gjykuar.

Përveç kësaj Gjykata e Apelit me shikim në shkresat e lëndës por edhe në bazë të arsytimit të aktgjykimit të ankimuar, nuk ka mundur të kuptoj se mbi bazën e cilit fakt apo rrethanë konkrete, gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundimin se në rastin konkret sa i përket llogaritjes së dëmit material të cilin paditësit e kanë pësuar në emër të zvogëlimit të aktivitetit punues (fitimit të humbur) ka qenë e nevojshme që të nxirren tri ekspertiza te pavarura nga lëmia financiare (aktuaristikës), aq më tepër kur kjo gjykatë me shikimin në dy ekspertizat e para të nxjerra në mënyrë të pavarur nga ekspertët Ukë Sadiku dhe Aziz Berisha, konstaton se të njëjtat janë punuar në tërësi sipas urdhrin që u ishte dhënë nga gjykata.

Sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit nëse gjykata e shkallës së parë për çfarëdo rrethane, qoftë duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare por edhe prapësimin të palëve në procedurë, ka vlerësuar dhe ardhur në përfundimin se qoftë ekspertiza e parë financiare, apo edhe ekspertiza e dytë e të njëjtës lëmi, nuk kanë qenë të plota dhe nga ekspertët e caktuar nuk janë nxjerr në përputhshmëri me urdhrin që u ishte dhënë nga vet gjykata, gjykata e shkallës së parë ka pasur për detyrim ligjor që paraprakisht në mbështetje të dispozitës së nenit 366 të LPK, nga ekspertët të kërkonte sqarime plotësuese në ekspertizat e tyre të bëra, apo eventualisht në kuptim të nenit 369 të po të njëjtit ligj, nëse ka vlerësuar se në mes dy ekspertizave të para ka dallime esenciale, të kërkoj sqarime nga të dy ekspertët lidhur me dallimet në konstatimet dhe mendimet e tyre, që përmes sqarimeve te dhëna në seancë, gjykata të kishte mundësi që të evitonte të metat dhe kundërthëniet në mes këtyre dy ekspertizave, e jo që lidhur më këtë të nxjerrte ekspertizë tjetër te re, siç ne rastin konkret ka vepruar përmes nxjerrjes se ekspertizës nga grupi i ekspertëve Riza Blakaj, Bashkim Uka dhe Maliq Krasniqi.

Përveç kësaj, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit falja e besimit ekspertizës nga lëmia financiar e punuar nga grupi i ekspertëve Riza Blakaj, Bashkim Uka dhe Maliq Krasniqi, nga ana e gjykatës së shkallës së parë, të njëjtën gjykatë nuk e ka liruar nga detyrimi ligjor që në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar të arsyetoj se cilat kanë qenë rrethanat apo faktet të cilat nga gjykata janë marr për bazë se pse gjykata ia ka falur besimin e plotë super ekspertizës, ndërsa nuk i ka falur besimin ekspertizave paraprake të nxjerra nga kjo lëmi, pasi që ne bazë te arsytimit të dhënë del se gjykata nuk ka treguar asnjë arsye lidhur me vlerësimin e bërë ekspertizave financiare të nxjerra nga ekspertët Ukë Sadiku dhe Aziz Berisha, të cilat i ka administruar si provë gjatë shqyrtimit kryesor.

Me dispozitën ligjore të nenit 160.4 të LPK, shprehimisht përcaktohet se *“arsyetimi i aktgjykimit përmban kërkesat e palëve faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si ka vërtetuar ato fakte, e po që si i ka vërtetuar me anë të provave cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato”*.

Në kuptim të kësaj dispozite ligjore, e për arsytet të cilat kjo gjykatë i cekti si me lartë aktgjykimi i ankimuar në pjesën e kërkespadi së lidhur me kompensimin e dëmit material paditësve në emër të zvogëlimit të aktivitetit punues (fitimit të humbur) dhe shpenzimeve te mjekimit, del te jetë përfshirë gjithashtu edhe me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës nga neni 182.1 dhe 182 pika n) të LPK, e lidhur me nenin 160.4, 366 dhe 369 të te njëjtit ligj.

Gjykata e Apelit me pikën III (tre) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke marr për bazë pjesërisht si te bazuar pretendimin ankimor të palës ankuese për zbatim të gabuar të ligjit material, aktgjykimin e ankimuar e ka ndryshuar edhe sa i përket kamatës së

gjykuar, pasi që kamata sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit del te mos jetë gjykuar në përputhshmëri me dispozitën ligjore të nenit 277 të LMD (Gazeta Zyrtare e RSFJ, nr. 29, datës 26 Maj 1978), ligj ky i cili ka qenë në zbatim në kohën kur në mes ndërgjyqësve ka lindur raporti i tyre detyrimor, si shkak i aksidentit të ndodhur në të cilin lëndime trupore kishin pësuar paditësit.

Me pikën IV (katër) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, aktgjykimin e ankimuar e ka prishur edhe në pjesën e kërkespadiësë lidhur me shpenzimet e procedurës, pa u lëshuar fare ne ligjshmërinë e kësaj pjesë të aktgjykimit, për faktin se kjo lëndë kontestimore në një pjesë u dashtë që të prishet dhe gjykatës së shkallës së parë ti kthehet në rigjykim, me çka pranë asaj gjykate ne procedurën e rigjykimit do të krijohen edhe shpenzime tjera procedurale, për të cilat gjykata e shkallës së parë duhet te vendos me rastin e marrjes se vendimit përfundimtar, duke pasur suksesin e palëve ne procedurë dhe kush ju ka dhënë shkas krijimit të shpenzimeve procedurale.

Gjykata e Apelit me pikën I (një) te dispozitivit të këtij aktgjykimi duke pranuar në tërësi si te bazuar pretendimin ankimor të palës ankuese për shkelje thelbësore te dispozitave te procedurës kontestimore, ka anuluar aktvendimin e ankimuar të nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë C.nr.212/11, i datës 01.04.2014, për shkak se kjo gjykatë me shikim ne shkresat e lëndës ka konstatuar se ankesa e të paditurës më të cilën e kishte goditur aktgjykimin e ankimuar C.nr.212/11, i datës 30.01.2014, ka qenë e ushtruar brenda afatit të paraparë me ligj.

Tek ky përfundim kjo gjykatë ka ardhur për faktin se ne bazë te flet kthesës e cila gjendet ne shkresat e lëndës rezulton se e paditura aktgjykimin e ankimuar C.nr.212/11, i datës 30.01.2014, e ka pranuar në mënyrë te rregullt me datë 28.02.2014, ndersa ankesën më të cilën e kishte goditur këtë aktgjykim, përmes postës rekomande nr. 1146312 e ka dorëzuar me datë 17.03.2014. Nën rrethanën e tillë kur merret për bazë rrethana se afati ligjor për paraqitje te ankesës ka filluar të rrjedhë nga data 01.03.2014 dhe si datë e fundit për paraqitje te ankesë ka qenë data 15.03.2014, për të cilën me shikim ne kalendarin e vitit 2014 del te ketë qenë ditë e shtune kur nuk punon gjykata, dhe se ditë kur nuk punon gjykata ka qenë edhe dita e nesërme, (e diell, datë 16.03.2019), nga kjo rezulton se ligjërisht dita e fundit ka qenë data 17.03.2017, datë kjo kur e paditura edhe del ta ketë dorëzuar ankesën përmes postës rekomande.

Me dispozitën ligjore te nenit 126.5 të LPK shprehimisht përcaktohet „*Kur dita e fundit e një afati bie ne ditë feste shtetërore apo ditën e diel ose në ndonjë ditë tjetër kur nuk punon gjykata, afati mbaron në ditën e punës qe vjen pas asaj te pushimit* “. Ndersa me dispozitën ligjore te nenit 127.2 të po të njëjtit ligj shprehimisht përcaktohet „*Në qoftë se parashtrësja është dërguar me anë te postës me letër rekomande apo ne rrugë telegrafike, dita e dorëzimit në postë konsiderohet si ditë e dorëzimit në gjykatën të cilës i është drejtuar. Po qe se parashtrësja është dërguar më anë te telefaksit si ditë e dorëzimit konsiderohet dita kur telefaksi është pranuar në gjykatë* “

Pra në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes sipas aktvendimit të ankimuar C.nr.212/11, i datës 01.04.2014, vendimin e saj e ka marrë me shkelje thelbësore te dispozitave te procedurës kontestimore nga neni 182.1 e lidhur me nenin 126.5 dhe 127.2 të LPK.

Si shkak i shkeljeve te konstatuara si me lartë, për të cilat kjo gjykatë aktgjykimin e ankimuar C.nr.212/11, i datës 30.01.2014, u dashtë qe ta prishë në pjesën e kërkespadiësë se paditësve për shpenzimet e mjekimit dhe zvogëlimit të aktivitetit

punues ( fitimit të humbur), gjykata e shkallës së parë ne riprocedurë udhëzohet që duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare edhe pa prapësimin e palëve në procedurë, nëse ka vlerësuar se qoftë ekspertiza e parë financiare, apo edhe ekspertiza e dytë e të njëjtës lëmi, nuk kanë qenë të plota dhe se ato nga ekspertët e caktuar nuk janë nxjerr në përputhshmëri me urdhrin që ju ishte dhënë nga vet gjykata, në mbështetje të dispozitës së nenit 366 të LPK, paraprakisht nga ekspertët të kërkoj sqarime plotësuese lidhur më ekspertizat e tyre të bëra, apo në kuptim të nenit 369 të po të njëjtit ligj, nëse vlerëson se në mes dy ekspertizave të para edhe pas plotësimit të tyre do të ketë dallime esenciale, të kërkoj sqarime nga të dy ekspertët lidhur me dallimet në konstatimet dhe mendimet e tyre, që pastaj të ketë mundësi që të ndërmerr edhe veprimet tjera të parapara me ligj në drejtim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike sa i përket kërkesës së paditësve për kompensim në emër të zvogëlimit të aktivitetit punues ( fitimit të humbur).

Meçe në shkresë të lëndës për paditësin ~~XXXXXX~~ <sup>Mentor Lupa</sup>, gjendet një vërtetim i lëshuar nga autoritetet e shtetit Belg me datë 10.09.2012, nga i cili rezulton se të njëjtit nga shteti Belg i është njohur invaliditeti në shkallën prej 66%, duke filluar nga data 05.08.2012, gjykata e shkallës së parë nuk ka pengesa që sipas detyrës zyrtare edhe pa propozim të palëve në seancë të ftoj edhe njëherë ekspertin e mbrojtjes në punë Dr. Kujtim Zajmi, më qëllim që i njëjti të deklarohet dhe sqarohet lidhur me një rrethanë apo provë të tillë, ngase në bazë të mendimit profesional të dhënë gjatë shqyrtimit kryesor nga i njëjti ekspert është konstatuar se ky paditës ka zvogëlim të aktivitetit të përhershëm punues në shkallën prej 100 %.

Aktgjykimi i ankimuar në pikën II (dy) të dispozitivit, e cila i referohet refuzimit të pjesshëm të kërkespadiës së paditësve në emër të dëmit jo material të kërkuar, nuk është shqyrtuar nga ana e Gjykatës së Apelit, pasi që në bazë të thënieve nga ankesa e ushtruar, kjo gjykatë ka konstatuar se kjo pjesë e aktgjykimit të ankimuar nuk është goditur nga pala ankuese.

Prandaj, nga të cekurat me lartë, e në mbështetje të nenit 195.1 pika c) d) dhe e), e lidhur me nenin 200, 201, 208 dhe 209 pika d) të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK) u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.1352/14, me datë 14.01.2019

Kryetari i kolegjit  
Qerim Ademaj, d.v